

TREGIMI I PEJGAMBERIT

NUH



Özkan Öze
Ilustroi: Sevgi İçigen

TREGIMI I PEJGAMBERIT
NUH



Në pamjet që ilustrjnë libërthat e kësaj serie botimesh për fëmijë nuk do të shihni asnjë nga fytyrat e pejgamberëve. Kjo sepse muslimanët nuk bëjnë portrete të pejgamberëve, për shkak të respektit që ndiejnë ndaj tyre.



BOTIMET E KRYESISË SË ÇËSHTJEVE FETARE TË TURQISË: 1706/2
Libra për fëmijë: 349/2

Drejtuesi i botimeve:

Dr. Fatih Kurt

Koordinatori i botimeve:

Lokman Arslan

Analizimi i veprës:

Hale Şahin

Elif Erdem

Editor

Zeynep Ulviye Özkan

Përktheu

Florida Kulla

Redaktor gjuhësor

Fatjon Cuka

Ndjekja e botimit

Uğur Altuntop

Botimi

Başak Mat. Tanı. Hiz. İth. İhr. Tic. Ltd. Şti.

Tel.: +90 312 397 16 17

Botimi i tretë, Ankara 2019

2019-06-Y-0003-1706

ISBN 978-605-7730-91-6

Numri i certifikatës: 12930

Vendimi i komisionit të hetimit të veprave : 12.11.2019/111

© Kryesia e Çështjeve Fetare të Turqisë

Kontakt

Dini Yayınlar Genel Müdürlüğü

Yabancı Dil ve Lehçelerde Yayınlar Daire Başkanlığı

Üniversiteler Mah. Dumlupınar Bulvarı No: 147/A

06800 Çankaya - ANKARA / TÜRKİYE

Tel.: +90 312 295 72 81 • Fax: +90 312 284 72 88

E-posta: yabancidiller@diyanet.gov.tr





Kaluan shumë vite që prej ardhjes së Pejgamberit
Adem në botë.

Shumë e shumë mote, me qindra, madje me mijëra
vite.

Njerëzit u shumuan dhe u përhapën në sipërfaqen
e tokës.

U ndërtuan fshatra, qyteza dhe qytete.

Numri i të këqijve e tejkaloi numrin e të mirëve.

Për më tepër, njerëzit e harruan Allahun dhe nisën
të adhurojnë statujat, pra, idhujt

Kushdo që kishte një hall vraponte drejt
idhujve:

“O idhull, të lutem më fal mua këtë apo atë!”

Kushdo që frikësohej nga diçka i
përgjërohej idhullit:

“O idhull, më mbro mua! Të lutem!”

Edhe ata që u ecnin punët mbarë shkonin
tek idhulli:

“Të falënderoj, o idhull, sepse
na ke shpëtuar!”





Por Nuhu ishte ndryshe!

Ai ishte një rob që falënderonte vetëm Allahun.

Dhe nuk adhuronte askënd tjetër, pos Allahut.

Kur i duhej të kërkonte diçka, e kërkonte vetëm prej Allahut,


sepse çdo gjë e kishte krijuar Allahu.

Kur trembej, mbështetej tek Allahu,

sepse Allahu ishte më i madh se çdo gjë tjetër.

Dhe kur hante një frut të shijshëm falënderonte vetëm Allahun.

Sepse vetëm Allahu mund të krijonte një frut të shijshëm për njerëzit
Ndërsa idhujt ishin pa shpirt e pa mendje.
Por me sa duket ata që kërkonin diçka nga idhujt





ishin më të pamend se vetë idhujt!
Dhe Allahu e bëri Nuhun Pejgamber.
Pejgamberi Nuh tha: "O populli im!
Hiqni dorë nga adhurimi i këtyre statujave prej guri,
druri dhe balte!
Kërkoni vetëm nga Allahu!
Dhe falënderoni vetëm Allahun!"

Njerëzit u zemëruan shumë me
Pejgamber Nuhun.
E sulmuan atë.





I thanë shumë fjalë të këqija.

Dhe e kërcënuan, duke i thënë se do ta godisnin me gurë...

Ndërkohë që Nuhu ishte një i dërguar, të cilin Allahu e kishte zgjedhur nga mesi i tyre dhe të gjithë duhet t'i besonin atij.


Vitet kaluan, njësoj siç kalojnë retë gjigande në qiell, por shumë pak njerëz treguan besim ndaj

Pejgamberit Nuh.

Mosbesimtarët kryenin shumë të këqija ndaj besimtarëve.

Pejgamberi Nuh frikësohej.
Madje frikësohej për të gjithë njerëzit
Atyre që adhuronin idhujt u tha: “Mos
veproni kështu!
Për shkakun tuaj Allahu do të na dërgojë
fatkeqësi!”
Ata i thanë: “Le t’i dërgojë e t’i shohim!”
Pejgamberi Nuh tha: “Allahu im!
I ftova njerëzit të të besojnë ty.
Por ata më kundërshtuan. Jam shumë i
trishtuar!”




The page features a colorful illustration. At the top left, a tree with a brown trunk and green foliage is partially visible. In the top right corner, a bright yellow sun is partially obscured by a large, white, fluffy cloud. Below the clouds, two hands are shown in a gesture of prayer or supplication, with palms facing upwards. The hands are wearing blue sleeves. At the bottom of the page, there is a border of green grass with several white daisies and a few orange flowers. A small pink butterfly with black markings is flying on the right side of the page.

Allahu i tha Nuhut: "Mos u trishto!"
Dhe e urdhëroi që të ndërtojë një anije.
Një anije të madhe, një anije shumë të
madhe!
Një anije shumë-shumë të madhe!
Por Pejgamberi Nuh nuk dinte si të ndërtonte
anije.
Allahu e mësoi se si të mund ta ndërtonte
atë.

Dhe Nuhu ia nisi punës menjëherë.
Preu pemë e barti dru.
Kur anija nisi të dukej dalëngadalë,
të gjithë u habitën.






Ata që nuk besuan te Pejgamberi Nuh i
thanë:

“Ha ha ha! Ku do të notojë kjo anije?”

Më në fund anija u ndërtua.

Ah sa anije e madhe ishte kjo!




Allahu e urdhëroi Pejgamberin Nuh që të merrte nga një mashkull dhe një femër prej të gjitha kafshëve.

Pejgamberi Nuh u tha: "Hipni në anije! Hipni në anije!
Nxitoni! Nxitoni!"

Kafshët, njëra pas tjetrës, të gjitha
çift, dhe njerëzit që besonin tek
Allahu hipën në anije me radhë.







Portat e anijes u mbyllën fort
Pas një kohe të shkurtër
qielli nisi të vetëtijë.
Më pas nisi një shi i frikshëm.
Ra shi, ra e ra shumë shi.
Ra aq shi, sa çdo anë u mbulua nga ujërat dhe
përmbytjet
Dhe anija u ngrit mbi ujë e nisi të notojë.
Në qiell pati bubullima për ditë të tëra.
Ra shi për ditë me radhë.
Ky ishte një tufan.




Askush tjetër, veç atyre që ishin në
anije nuk shpëtoi nga tufani.
Edhe ata që u ngjitën në malet më të
larta u përmytën nga ujërat



Pas disa ditësh, javësh e muajsh shiu reshti,
sepse Allahu e urdhëroi atë që të pushojë.
Dhe dielli i verdhë e i ngrohtë i Allahut buzëqeshi
sërish ndaj botës, pas reve të mëdha...
Anija u vendos e padëmtuar në malin Xhudi.



Kafshët njëra pas tjetrës dhe njerëzit besimtarë
zbritën nga anija me shend e hare.





Dhe sipërfaqja e tokës u gëzua me njerëzit
që panë sërish netët,
yjet, ditët dhe lulet dhe që thoshin: "Sa bukuri
paska krijuar Allahu!" ...

